



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	182 / 23
Nr. i fq. / Br. st	- 22 -
Data: / Datum	27. 07. 2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -VI- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 29-30 QERSHOR 2023

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Nurie Halili dhe Fakete Dushi.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 31 anëtarë të kuvendit, kuorum i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-paraqiti para kuvendit pika e dërguara në të ndryshme për ti inkorporuar në rendin e ditës.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – pasi i përshëndeti të pranishmit fillimisht ju uroj Festën e Kurban Bajramit, gjithë qytetarëve të Vushtrrisë. Më vjen shumë keq që në këtë ditë feste më duhet të përball Kryetarin me disa fakte dhe argumente për menaxhim shumë të dobët të buxhetit dhe projekteve Komunale. Të nderuar anëtar të Kuvendit, vitin e kaluar Komuna e Vushtrrisë ka pasur 4.5 milion euro të pashfrytëzuara ku gjysma e tyre kanë shkuar suficit, pra Komuna jonë i ka humbur këto para. Këtë humbje Kryetari e ka arsyetuar disi me vonesën e miratimit të buxhetit për vitin e kaluar. Mirëpo këtë vit buxheti është miratuar me kohë dhe është votuar në mënyrë unanime nga kuvendi, po realizimi i buxhetit për këtë vit është edhe më i dobët nga ana e kësaj qeverisje Komunale. Deri në muajin e tretë të këtij viti, komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar zero euro në shpenzimet Kapitale, ndërsa në gjashtë mujor, pra deri në këto qaste që po flasim, ka arritur të shpenzoj vetëm 1% të buxhetit për shpenzime kapitale. Me këtë performanc del që në fund të vitit buxheti për shpenzime kapitale të shpenzohet vetëm 3%. E dimë që në muajt e fundit komuna

do të paguaj për punë që ende nuk kanë përfunduar, sepse kështu vepruan edhe vitin e kaluar, por prapë buxheti nuk do të mbërrij aty ku duhet të mbërrinte. Në vitin e kaluar komuna e Vushtrrisë ka shpenzuar rreth 50% të buxhetit për investime kapitale, e që për këtë vit, synimi do të duhej të ishte së paku 70%, por fatkeqësisht jo. Kjo mënyrë e qeverisjes rrezikon komunën tonë që për vitin e kaluar dhe këtë vit t'i humb mbi 10 milion euro. Humbja e këtyre mjeteve është më e madhja ndonjëherë në qytetin e Vushtrrisë dhe është një papërgjegjësi totale e Kryetarit karshi qytetarëve. Ndoshta Kryetari është duke e menduar dorëheqjen, ose është duke kërkuar ristrukturim të qeverisjes Komunale, që këtë dështim dhe mos punë të adresoj tek drejtorët komunal. Jo Kryetar, këto dështime nuk mund t'i justifikosh me ndërrimin e disa drejtorëve, sepse ata më së paku kanë faj në këtë situatë, përveç Drejtorisë së Prokurimit Publik, por drejtorin e kësaj drejtorie e keni paraqitur si një personalitet shumë të përgatitur dhe me përvojë?! Pyetja është se a e ka ditur drejtori se cilat do të jeni detyrat dhe përgjegjësit e tij në këtë dikaster, a është i vetëdijshëm drejtori për dëmin që po u a shkakton qytetarëve të Vushtrrisë? Shpesh herë kemi dëgjuar se drejtori ka lexuar shumë, por me gjasë paska lexuar shumë Vepra, Vepra Filozofike, por me Filozofi nuk udhëhiqet prokurimi e as komuna Kryetar.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –pasi uroj të gjithë qytetarët për festën e Kurban Bajramit, paraqiti një rezymë për qeverisjen komunale në gjatë mujorin e parë të vitit 2023, ku apostrofoj se për këtë periudhë kemi parë dështimin e radhës të qeveris komunale në realizimin e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë. Dështimi ka të bëjë se në tre mujorin e parë të këtij viti kemi zero përqindë shpenzim të buxhetit në investime kapitale. Kjo situatë e komunës sa i përket buxhetit ka qenë ekuivalente vetëm me komunat veriore të Republikës së Kosovës, të cilat gjatë kësaj periudhe nuk kanë pasur fare kryetar komunash, kjo gjendje është konstatuar edhe nga organizatat e pavarura të shoqërisë civile. Në momentin që po flasim realizimi i buxhetit është vetëm 1% dhe imagjinon tani jemi në gjysmën e këtij viti kalendarik dhe shifrat në shpenzim të buxhetit janë katastrofëale. Ndrysh shprehur në përqindje për muaji i bie 0.16% për secilin muaj. Shtrohet pyetja si do të jetë përqindja në fund të vit për realizimin e buxhetit të komunës për vitin 2023? Në këtë gjashtë mujor kemi pasur seri të anulimit të vendimeve dhe tashmë anulimet nuk po ndodhin vetëm në konkurse, por edhe në zbatimin e vendimeve dhe rregulloreve që i nxjerr vetë kuvendi. Kemi parë se si u anulua rregullorja për orarin e bizneseve për ditët e festave zyrtare. Kujtojmë se me 30 prill 2023 ditë e diel u pushua, ndërsa të hënën me 1 maj 2023 në kundërshtim me rregulloren për ironi në ditën e të drejtave të punëtorëve është punuar. Nuk shkoj shumë gjatë dhe ndodhi ajo që kishin paralajmëruar dhe u anulua tërësisht zbatimi i rregullores me një arsyetim qesharak për shkak të reshjeve të shiut. Në këta gjashtë muaj kemi parë rënie drastike të indeksit të transparencës komunale dhe këtë e thonë organizatat e pavarur kredibile të shoqërisë civile që merren me monitorimin e komunave. Në këtë periudhë kemi parë dështimin e radhës në shëndetësi duke shpall konkurs të kundërligjshëm për kryetëknik në laborator, dhe për këtë nuk kishin marr mendimin dhe paralajmërimin e subjektit të tij politik në Vushtri dhe kjo shkaktoj shumë pasoja ku gati për një vit QKMF-ja mbeti pa kryetëknik në laborator dhe pa specialist të biokimisë pra është duke u punuar në mënyrë të kundërligjshme. Për më keq e mbyllen laboratorin në QKMF e vjetër dhe u hapë në objektin e ri në katin e dytë ku u vështirësua ofrimi i shërbimeve dhe për të qenë akoma më keq ka rënë numri i parametrave diagnostik apo numri i ofrimit të shërbimit të analizave laboratorike në QKMF në përgjithësi. Në këta gjashtë muaj kemi parë njoftime në vend të vendimeve për anulim të konkurseve kemi parë keqpërdorime dhe kallëzime penale për konkursin në Çerdhen e Qytetit “Foleja” në këtë kontekst kemi parë se nuk u respektua normativi ligjor duke u mposhtur kandidatët me përvojë pune të diplomuar në Universitetin Publik të Prishtinës e duke u pranuar kandidat për përvojën e nevojshme të punës dhe të diplomuar në universitetet private.

Po ashtu në këtë periudhë kemi parë kaos në rrugët e qytetit duke i shndërruar rrugët dy kahore në rrugë njëkahore, për bërë një analizë të mirëfilltë dhe pa bërë matjet e njëmend me të dhëna empirike, për efektin e këtyre vendimeve, për këtë sot kemi pranuar disa peticione të qytetarëve që janë ankuar se përpos kaosit ata janë dëmtuar edhe në bizneset e tyre private që i posedojnë. Çfarë nuk kemi parë në këtë qeverisje nuk kemi parë akoma masa mbështetëse për të prekurit nga vërshimet e fundit që kanë ndodhur në Komunën e Vushtrrisë. Lidhur me këtë ai potencoi se Lëvizja Vetëvendosje në Vushtrri ka propozuar 7 masa për komunën për rimëkëmbje dhe zhvillim. Në fund ceku se për këtë periudhë kanë ndodhur gjëra të cila kanë vetëm një emërues të përbashkët e ajo është dështim i Qeverisje Idrizi.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- pasi i uroj të gjithë qytetarët për festën e Kurban Bajramit, u përgjigj në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit duke potencuar se nuk ka pritur nota apo vlerësim më të lartë nga oponentët politikë dhe shtoj se LDK në Vushtrri ka mbajtur një konferencë për shtyp me nja tre apo katër vetë dhe për ironi kishte dashur që edhe vetë ai t'i bënë pëlqim apo like siç thuhet në gjuhën e rrjeteve sociale postimit të tyre për ti marr nja shtatë apo tetë pëlqime. Në këtë prononcim kishte pasur krahasim të raportit të auditorit të përgjithshëm në këtë rrafsh thënë sinqeritetin ose duhet të mendosh se je tepër i mençur për të iu hedhur hi syve qytetarëve për të dal e për ti krahasuar dy raportet. Kjo për faktin se raporti i auditorit të përgjithshëm për vitin 2021 kur LDK ka qeverisë me Komunën ka qenë raport i kualifikuar d.m.th. me të gjetura me keqpërdorime me keq menaxhim dhe ta krahasosh me raportin e vitit 2022 të mandatit të tij që i është i pakualifikuar pa të gjetura pa keqpërdorime me disa rekomandime për të cilat kemi marr obligim që ti përmirësojmë. Sa i përket shpenzimit të buxhetit në vitin 2021 ka qenë vetëm 45% dhe rritjen e ka bërë pagesat e obligimeve ndaj mësimdhënësve përmes përmbaruesit që rritja ka shkuar në 55%. Pastaj shtoj se për 4 vitet qeverisjes LDK-LVV zyrtarët e komunës janë ngrohur me ngrohëse me tela dhe ka pasur shpenzime enorme në energji elektrike, mandej nuk është vendosur as një laurë dhe vijat e parkingut të komunës, nuk ka pasur ujë në banjat e komunës dhe nuk di me të vërtet se si ka funksionuar komuna pa ujë, andaj tani këto punë janë përfunduar me suksese nga qeveria aktuale. Pastaj me kërkesën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, janë grumbulluar të gjitha kërkesat e qytetarëve për rrugë, kanalizime, ujësjellës e të ngjashme deri në muajin shtator 2021 dhe përfundimisht në muajin shtator iu kanë kthyer përgjigje qytetarëve me tekstin i nderuar kërkesa e juaj është realizuar rruga do të përfundohet dhe projekti do të kryhet shumë shpejt. Tani ata qytetar të mashtrua nga ish qeveria vinë në komunë dhe kërkojnë të dinë se çfarë po ndodhe por ai iu ka treguar të vërtetën se kjo punë është bërë vetëm për vota. Mandej 156 perona janë zënë me punë me kontratë mbi vepër në mënyrë të kundërligjshme dhe 370.000.00 € janë dedikuar për hartim të projekteve dhe që asnjë projekt nuk është realizuar ndërsa mjetet janë keqpërdorur, por ai nuk dëshiron të futet në këto tema sepse nuk pret vlerësimin nga kuvendarët por nga qytetarët e komunës së Vushtrrisë. Pastaj shtoi dhe deklaroi se gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të përballur me vërshime asnjëri nga anëtarët e kuvendit me përjashtim të z.Mek Selaci dhe deputetes Rrezarta Krasniqi, nuk kishte shprehur as interesimin më të vogël për qytetarët e komunës edhe pse besimin elektoral e kanë marr nga po këta qytetar. Në lagjen e Kastratëve, si rezultat i devijimit të një projekti nga qeveria e kaluar dhe aty ka mbet një urë e vjetër e ndërtuar para 40 viteve dhe si pasoj e ngushtimit të shtratit të lumit afër kësaj ure duke mos iu përshtatur konstruktit të urë, dhe kjo ka sjellë pasoja në vërshimin e kësaj lagje, qeveria e komunës e ka rrënuar atë urë për t'i shpëtuar atë lagje dhe qytetarët atje. Anulimi i rregullores për orarin e veprimtarive biznesore, ka ndodhur sepse vetë kuvendi ia ka mundësuar suspendimin e saj dhe pret që me Qeverinë e Kosovës të gjej zgjidhje sepse ka bashkëpunim të shkëlqyeshëm, sidomos në lëmin e bashkëfinancimit të projekteve infrastrukturore rruga nga Pestova në Druar,

por edhe ndërtimi nga qeveria qendrore i rrugës magjistrale. Sa i përket rregullimit të komunikacionit shtoj se tani kur vinë mërgata do të ketë kaos në rrugët e qytetit për shkak të numrit të madh të automjeteve, por kjo çështje është në dorën e ekspertëve dhe do të shikohet se si do të funksionoj. Lidhur me mbështetjen për të prekurit nga vërshimet komuna e ka planin dhe i ka statistikatat për të dëmtuarit nga vërshimet dhe komuna do të ofroj ndihmë konform kapaciteteve të saj financiare. Në fund lidhur me shpenzimin e buxhetit vlerësoi se ka vonesa në procedurat e prokurimit por shpreson që shpejt do të fillojnë punët në tërë territorin e komunës.

Albanez Tahiraj, drejtor i Drejtorisë së Prokurimit-duke ju përgjigjur anëtarit të kuvendit z.Lahu, ceku se janë nënshkruar 28 kontrata të prokurimit me vlerë financiare prej afër 1 milion euro dhe ato janë publike, ndërsa kontratat tjera me vlera të mëdha financiare pritet që gjatë javës të nënshkruhen. Pastaj shtoi dhe deklaroi se nuk e trason rrugën e qeveritarëve të kaluar për negociim dhe pazare me tender në dëm të parasë publike, edhe pse ka prova se ka kërkesa për negociime me operator ekonomik për tenderët e komunës. Koha e negociimit dhe kurdisjes së tenderëve siç ka ndodhur në të kaluarën ka përfunduar tashmë.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se është për keqardhje qasja e kryetarit të komunës për ti ikur debatit në thelb të problemeve siç është ai për buxhetin e komunës dhe shpenzimin e tij, në prononcimin e tij para televizionit publik ai kishte deklaruar se ai nuk realizon asnjë investim pa projekt dhe se ai nuk shkon në ministri për të kërkuar mjete sepse nuk i ka të gatshme projektet. Por kryetari ose ka problem me terma ekonomik ose nuk e kupton se mjetet financiare për investimet kapitale janë në komunë ose në të vërtetë është duke e fyer inteligjencën e qytetarëve të Komunës së Vushtrisë. Pyetja është e thjeshtë pse nuk po shpenzohet buxheti?

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se anëtar i kuvendit Adnan Lahu po tenton ti mashtrtoj qytetarët, sepse deklarimi i tij ka qenë në pyetjen se a ka marr komuna para nga ministria përgjigja e kryetarit ka qenë jo sepse nuk kanë mundur t'i hartojnë projektet, ndërsa kur e ka bërë komuna projektin e gatshme ka përfituar projekt prej 720.000.00 € për financimin e ndërtimit të rrugës “Drenica”, e po ashtu komuna ka përfituar edhe projektet tjera siç është ai për ujitjen dhe projektet me bashkëfinancim, ndërsa tendenca me lojë me terma ekonomik për fondet e komunës për investime kapitale dhe mjetet nga ministria është tendencë për ndërtim të opinion të rrem dhe për ti mashtruar qytetarët nga anëtar i kuvendit Adnan Lahu. Ai po ashtu foli në superalitiv për menaxhimin e mirë që ka bërë me vërshimet që ka ndodhur kohëve të fundit dhe jo si në të kaluarën kur në janar të vitit 2021 ka pasur dëme materiale deri në 4 milion euro, por tani është investuar në hapjen e kanaleve dhe lumenjve dhe është mënjeluar dëmi nga vërshimet. Fakti se është menaxhuar mirë situata me vërshimet në komunë del nga fakti se brenda gjysmë ore është themeluar shtabi emergjent dhe është shpallë gjendje e jashtëzakonshme në komunë, ndërsa komunë dhe kryetari i janë përgjigjur të gjithë operatorët ekonomik, dhe a e din pse sepse kryetari i komunës nuk i ka vjedhur këta operator siç ka ndodhur në të kaluarën.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –adresoq shqetësimin dhe kërkesën e qytetarëve për futje në rendin e ditës plotësim-ndryshimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave konkretisht neni 3 tarifat për bizneset-lokalet afariste me hapësirë 1-20 m² me tarifë nga 5-7 € dhe kjo pa u bërë klasifikim se cilat biznese prodhojnë më shumë mbeturina. Po ashtu edhe tek lokalet afariste prej 21-50m² nuk kemi klasifikim por shkohet me tarifë fikës gjë e cila nuk krijon një politikë të drejtë të vendosjes së tarifave komunale. Lokalet prej 50m² kanë paguar prej 23-25 €, ndërsa lokale e njëjta në Komunën e Prishtinës kanë paguar 7.50€, kjo është e pa drejtë dhe po i dëmton veprimtaritë e biznesit. Kërkoj që ndryshimi i kësaj rregullore të bëhet në një afat sa më të shkurtër.

Behar Duraku, anëtar i kuvendit – në adresimin e tij para kuvendit ngriti tri çështje të cilat kanë të bëjnë me shqetësime të qytetarëve çështja e parë ka të bëjë lidhur me hapësirën publike para

kalasë se qytetit e cila është uzurpuar nga bizneset me konkretisht hapësira gjelbërues prandaj kërkoj nga Drejtoria e Inspektimeve që të ndërmerri diçka lidhur me këtë shqetësim. Çështja e dytë ka të bëjë me ujin e pijes i nderuar kryetar drejtor i shërbimeve publike me çdo të dytin qytetar që takohem me pyesin se kur do të kemi ujin në qeshmet prandaj dhe unë kam po të njëjtën pyetje kur do të kenë qytetaret ujin në qeshmet e tyre është fjala për zonën nga vije Stroc- Zhilivode Gllavatin Bivolak Beçuk Mihaliq. Dhe çështja e tretë është lidhur me rrugën R 220 Bukosh Prilluzhe i nderuar kryetar rruga është duke u dëmtuar në masë të madhe nga kamion të cilët e bartin zhavorrin për rregullimin e hekurudhës, shqetësimi është i madh i banoreve prandaj kërkoj nga ju që me autoritetin e juaj të ndikoni në Ministrinë e Infrastrukturës dhe të vije deri te një zgjidhje pasi që dihet se kjo rrugë i përket Ministrisë së Infrastrukturës.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-ngrit shqetësimin e banorëve tek rr. “Ismajl Qemajli” për disa lodra që janë vendosur afër banesave kolektive pyetja për DUMM është se a ka leje për vendosjen e tyre në atë lokalitet.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-në përgjigjen e tij për anëtarët e kuvendit, vlerësoi se pajtohet me propozimin për ndryshimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave sepse ka pasur shumë vërejtje sa i përket kësaj rregulloreje dhe kërkoj nga DSHP-ja të iniciojë me ndryshimet e duhura. Lidhur me çështjet e ngritura nga anëtari i kuvendit Behar Duraku, njoftoi se do të rishikohet çështja e uzurpimit të pronave publike. Lidhur me ujin e pijshëm në zonën e Artakollit dhe zonave tjera njoftoi se është ndarë buxheti për financimin e pompave për lëshimin e ujit në Mihaliq dhe tek vendi i quajtur tek BINI afër Dunicës së Poshtme. Sa i përket rrugës rajonale nga Bukoshi në drejtim të Mihaliqit është një problem serioz shkatërrimi i asaj rruge dhe për këtë do ta ngrit si çështje në Ministrinë e Infrastrukturës.

Fortuna Krasniqi-drejtoreshë e DUMM-së-sqaroi se ka pranuar një kërkesë për vendosjen e disa lodrave në pronën private afër rrugës “Ismajl Qemajli” dhe janë duke e shqyrtuar këtë çështje sipas ligjit në fuqi.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –pyeti se ku gjendet drejtori i Drejtorisë së Inspektimeve i cili mungon për disa seanca dhe as në muajin prill nuk e sjellë para kuvendit informatën që e ka pasur për obligim ta procedoj.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit –tha se edhe në mandatin e kaluar ka kërkuar që shtëpia e <Kahriman Pasomës> ku janë ekzekutuar në mënyrën më mizore 68 shqiptar në maj të vitit 1999, andaj kërkoj që kjo shtëpi të shndërrohet në shtëpi-muze apo muze gjenocidi dhe që komuna atë pronë ta blejë duke e shtetëzuar për ta përkujtuar në kujtesën kolektive të popullit se çfarë kishte ndodhur në atë shtëpi krim dhe gjenocid mbi popullin shqiptar nga regjimi vrastar serb. Po ashtu edhe shtëpia e Selatin Gërzhaliut të shndërrohet në shtëpi-muze nëse këto nuk bëhen ka rrezik të humbjes së gjurmëve dhe kështu të rrafshohet historia së bashku me ato shtëpi.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit – lidhur me pikat e rendit të ditës të dërguara në të ndryshme, shtoj se propozimet për lokacionet e çerdheve publike janë të natyrës urgjentet dhe do të përkrahin ndërsa propozim-vendimi për këmbimin e pronës komunale nuk ka ndonjë urgjencë dhe si të tillë do nuk do ta përkrahin. Lidhur me këmbimin e pronës thuhet se krijohet qasje në rrugën publike por kjo në saj të skicës shihet ka qasje në rrugën publike dhe për këtë nuk e sheh se ku është interesi i komunës për këmbimin e kësaj prone. Për këtë pronë mungon vlerësimi nga Ministria e Financave, andaj propozoi që kjo pikë të mos futet në rendin e ditës.

Nexhmedin Rashica, drejtor i DSHPS-së-kërkoj që pika e 9 e rendit të ditës-kërkesa nga shoqata e të burgosurve politikë të hiqet nga rendi i ditës dhe e njëjta të shqyrtohet në Drejtorinë e Shëndetësisë.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-kërkoj që pika 5 dhe 6 të shqyrtohen bashkërisht pasi që kanë natyrë të njëjtë.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –deklaroi se i mbështet pikat e rendit të ditës të dërguara në të ndryshme, ndërsa kërkoj të përmirësohet gabimi teknik për sa i përket arsytimit të propozimeve për caktimin e lokacionet për çerdhet publik ku në arsyetim në të tri propozim-vendimet ceket lokacioni Bukosh. Ndërsa kërkoj që propozimet për çerdhe të vendosën si pikë e parë e rendit të ditës për shkak të rëndësisë që kanë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –vlerësoi se pika e dërguar në të ndryshme duhet të futen në rendin e ditës dhe të njëjtat të trajtohen, sepse këto çështje janë të rëndësishme për komunën dhe interesin qytetar, ku kemi të bëjmë me përfitimin e donacioneve për ndërtimin e çerdheve si dhe pika e këmbimit të pronë që është në interes për komunën dhe për biznesin në fjalë. Lidhur me kërkesën e Shoqatës të Burgosurve Politikë ceku se kishte me qenë mirë që e njëjta të trajtohet nga kuvendi dhe të marr një përfundim.

Në vazhdim kuvendi me vota “unanime” vendosi që pika 5 dhe 6 e rendit të ditës të trajtohen në mënyrë të bashkuar si një pikë e vetme.

Lidhur me pikën e 9 të propozuar në rendi të ditës <Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së Burgosurve Politikë>, kuvendit pas votimit me 17 vota “për”, 12 vota “kundër” 1 votë “abstenim” vendosi që kjo pikë të hiqet nga rendit i ditës dhe të trajtohet nga Drejtoria e Shëndetësisë.

Për propozim –vendimet për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e çerdheve publike në fshatin Bukosh, Smrekonicë dhe Stanoc i Poshtëm kuvendi me vota “unanime” vendosi që këto propozime të inkorporohen në rendin e ditës, si pikë e 2 në rend dite.

Lidhur me propozim-vendimin për këmbimin e pronës mes Komunës së Vushtrrisë dhe Ariani Company Sh.P.K. kuvendi pas votimit me 16 vota “për” 11 vota “kundër” të tjerat “abstenim” ky propozim shtohet në rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-kërkoj të futet në rendin e ditë propozim-vendimi për financimi e përbashkët të projektit për ndërtimin e objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtri. Ai ceku se me këtë propozim vendim autorizohet kryetari i komunës që nënshkruaj memorandum mirëkuptim për financimin e përbashkët për ngritjen e këtij objekti sipas përqindjeve dhe vlerave financiare që palët do të bien dakord mes veti. Ky projekt do të ketë financim të përbashkët dhe do të jetë konfom nevojave të kësaj organizate si dhe në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal.

Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi që bëhet pjesë e rendit të ditës Propozim-vendimi për financimi e përbashkët të projektit për ndërtimin e objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtri.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 27 vota “për” 1 votë “kundër” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 maj 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovim i Propozim-vendimeve për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e çerdheve publike në fshatrat Bukosh, Smrekonicë dhe Stanoc i Poshtëm;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2024-2026 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Planit Komunal për Integritet 2023 – 2025;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Vushtrrisë 2023 – 2025;
6. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me rrugën “Wesly Clark”;
7. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 82/23, të datës 30.03.2023;
8. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë lidhur me caktimin Lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;
9. Shqyrtimi i kërkesës për financimin e botimit të librit “Rrezet e Lirisë – Dëshmorët e Kombit të Zonës së veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës;
10. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, për periudhën janar – maj 2023;
11. Shqyrtimi i Raporti lidhur me gjendje momentale në Komunë Vushtrrisë pas vërshimeve dhe mundësia për përkrahje financiare për të dëmtuarit;
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ariani Company Sh.P.K. me pronarë Naser Imeri dhe pronës në pronësi komunale;
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim –vendimit për financim të përbashkët të projektit “ndërtimi i objektit për nevoja të kryqit të kuq të Kosovës dega në Vushtri”
14. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 maj 2023;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 maj 2023.

2. Shqyrtimi dhe aprovim i Propozim-vendimeve për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e çerdheve publike në fshatrat Bukosh, Smrekonicë dhe Stanoc i Poshtëm;

Remzi Ahmeti, drejtor i DGJKP-së-sqaroi se nëse ministria e linjës kërkon hapësirë më të madhe se 10 ari sipërfaqe komuna mund të ofroj.

Dardan Abazi, drejtor i DKA-së-njoftoi se në saj të një hulumtimi që ka bërë Ministria e Arsimit, dhe varësisht nga tipi i çerdhes që do të ndërtohet dhe është konstatuar se aty ku kemi gravitim më të madh të nxënësve aty është vendosur të ndërtohen çerdhe. Po ashtu duke u bazuar në tipin e çerdhes ministria mund të kërkoj rritjen e sipërfaqes për këto lokacione p.sh. në Stanoc të Poshtëm, mund të shkohet deri në 30 ari sipërfaqe ndërsa në fshatin Smrekonicë nga 10 në 15 ari sipërfaqe.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit –kërkoj sqarime nga DKA se nëse ministria në bashkëpunim me UNICEF-in ka bërë hulumtim atëherë ai duhet të në dërgohet për ta parë sepse ai duhet të jetë publik. Por para se të merret mendimi i ministrisë dhe organizmave tjerë duhet pasur parasysh se kuvendi dhe komuna ka disa plane normativa dhe po ashtu edhe disa zotime publike. Në këtë kontekst ceku se nga komisioni i kuvendit ka dal një rekomandim dhe është votuar në kuvend që shkolla e vjetër në Stanoc të Epërm të shndërrohet në çerdhe, dhe atëherë pse duhet të ndërtohet edhe një çerdhe tjetër në Stanoc dhe rajoni tjetër i komunës nga Shtitarica në Ashlan Taraxhë e Liqej ky rajon po mbetet pa çerdhe për fëmijë. Andaj nëse kryetari i komunës mban zotimin e tij që objekti i shkollës së vjetër në Stanoc të Epërm të shndërrohet në çerdhe publike atëherë nuk është e drejt që në një lokalitet të bëhet me dy çerdhe e një lokalitet të mbetet i pa mbuluar fare me çerdhe. Në fund kërkoj të bëhet e ditur se si do të qëndroj puna me rekrutimin e stafit nëpër këto çerdhe d.m.th a është lejuar nga ministria e linjës rekrutimi i këtij stafi.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-deklaroi se objekti i shkollës së vjetër në fshatin Stanoc i Epërm do të shndërrohet në çerdhe publike sepse për këtë është zotuar para kuvendit dhe qytetarëve. Për këtë çështje është shpallur një tender për kontraktimin e një kompanie për hartimin e projekteve dhe në kuadër të kësaj do të hartohet projekti ku do të ndryshoj edhe dizajni i kësaj çerdheje. Ndërsa sa i përket fshatrave Akrashticë, Shtitaricë, Pantinë dhe Ashlan edhe në këtë drejti do të bëhet një projekt për ndërtimin e një çerdheje publike. Lidhur me rekrutimin dhe pagesën e stafit të çerdheve publike është biseduar me Ministrinë e Arsimit dhe do të gjendet një zgjidhje nga ana e kësaj ministrie. Më tej shtoj dhe njoftoi se janë duke bërë përpjekje për stabilizimin e stafit kadrovik nëpër shkolla duke akomoduar zyrtar që janë punësuar në të kaluarën si bibliotekistë pa pasur fare bibliotekë dhe ata varësisht nga profesioni i tyre do të angazhohen si mësimdhënës. Në saj të kësaj politike kadrovike që ka zhvilluar komuna është bërë e mundur punësimi i psikologëve nëpër shkolla. Lidhur me lokacionet e çerdheve sqaroi se ministria e linjës ka kërkuar që sipërfaqja të jetë më e madhe se 10 ari të rritet në 15 ari për lokacionin në fshatin Smrekonicë, ndërsa në Stanoc të Epërm të rritet sipërfaqja në 30 ari.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –tha se propozimi për lokacionet e këtyre çerdheve publike është tepër i qëlluar, kjo për faktin se kur është vendosur për këto lokacione është marrë për bazë kriteri gjeografik si dhe kriteri demografik sepse p.sh Stanoci është bashkësia lokale më e madhe në Komunën e Vushtrrisë. Caktimi i lokacionit në fshatin Stanoc i Poshtëm është më vend jo pse kjo çerdhe mund të shfrytëzohet edhe nga banorët e fshatit Lumadh, por edhe nga banorët e fshatrave të Artakollit derti sa të bëhet një zgjidhje tjetër. Në rastin konkret ai i përkrahi këto propozim edhe për faktin se është donacion nga Ministria e Arsimit dhe kjo do ta ndihmon komunën tonë në realizimin e këtyre projekteve jetike për qytetarët tanë.

Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit –tha se nëse vendoset që në fshatin Stanoc të bëhen dy çerdhe, dhe të lihet pa çerdhe bashkësia lokale në fshatin Maxhunaj kjo është e padrejtë sepse duhet të kemi një orientim racional dhe të balancuar të investimeve kapitale. Më tej shtoi se ai nuk është kundër që të bëhen çerdhe por duhet të kemi një politikë të drejt edhe në orientimin e ndërtimeve të çerdheve. Andaj ky nuk është një gjykim i drejt, dhe i vjen shumë keq që asnjëri nga anëtarët e kuvendit nuk po ka guxim ta ngrit zërin për një padrejtësi që po bëhet në relacion me orientimin e investimeve kapitale prej lokaliteteve të tyre prej nga vinë në kontekst të ndërtimit të këtyre çerdheve.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –duke ju referuar parafolësit të tij, ceku se nuk është çështje e guximit për të diskutuar për gjëra substanciale, por ai diskuton mbi bazën e fakteve dhe parimeve që janë të qëndrueshme. Më tej shtoj se lokacionet për ndërtimin e çerdheve janë të qëlluara dhe

duhet të shfrytëzohet ky donacion nga ana e ministrisë për realizimin e këtyre projekteve. Kërkoj nga sekretaria e kuvendit të sillt në kuvend lista e pagave për anëtarët e kuvendit.

Në vazhdim kuvendi lidhur me propozim-vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhe publike në fshatin Bukosh, pas votimit me 24 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit-çerdhe për fëmijë në fshatin Bukosh, në pjesë të parcelës kadastrale P-70202010-00092-0, në sipërfaqe prej 1000 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 14617 m², Zona Kadastrale Bukosh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit
4. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me propozim-vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhe publike në fshatin Smrekonicë, kuvendi pas votimit me 25 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit-çerdhe për fëmijë në fshatin Smrekonicë, në pjesë të parcelës kadastrale P-70202062-00302-2, në sipërfaqe prej 1500 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 11187 m², Zona Kadastrale Qytezë, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit
4. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me propozim-vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e çerdhe publike në fshatin Stanovc i Poshtëm, kuvendi pas votimit me 24 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit-çerdhe për fëmijë në fshatin Stanovc i Poshtëm, në pjesë të parcelave kadastrale P-70202028-00787-1 dhe P-70202028-00787-3, në sipërfaqe prej 3000 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 33903 m², Zona Kadastrale Stanovc i Poshtëm, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit

4. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2024-2026 dhe kalendarit kohor për mbajtje të takimeve me qytetarë;

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se përmbajtja e kësaj kornize na paraqet qartë dhe saktë në kapituj ndër tjera:

- Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore;
Korniza Fiskale;
Korniza makroekonomike komunale;
- Tendencat e të hyrave komunale dhe parashikimet 2024-2026;
Donatorët e jashtëm;
Politikat e reja.
- Tendencat e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2024-2026 si dhe
- Korniza e Performances së Shpenzimeve.

Vizioni i komunës me këtë kornizë afatmesme buxhetore për vitin 2024-2026 është që të krijohen mundësi potenciale për zhvillimin e infrastrukturës, biznesit, agrobiznesit dhe të shfrytëzimit të burimeve natyrore duke ruajtur ambientin dhe trashëgiminë kulturore dhe kjo paraqet shembull të hartimit strategjik komunal. Në aspektin e strategjisë zhvillimore, Komuna e Vushtrri ka Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal ku janë parapare strategjitë zhvillimore sektoriale dhe janë përshkruar projektet për implementimin e tyre. Kështu që prioritetet komunale duhet inkorporohen me prioritetet qeveritare dhe nga kjo del se në KAMBK duhet të jenë prioritet i projekteve që janë në përputhje me prioritetet e Qeverisë. Ne duhet të prezantojmë dhe do të diskutojmë gjatë periudhës së diskutimeve publike prioritetet që pretendojmë t'i arrijmë përmes kësaj strategjie. Këto prioritete sektoriale janë radhitur si vijon:

QËLLIMI 1 - Të krijohet një klimë e favorshme për zhvillimin e biznesit;

QËLLIMI 2- Të përmirësohet cilësia e shërbimeve publike dhe infrastrukturës;

QËLLIMI 3 – Të zhvillohet turizmi rural;

QËLLIMI 4- Të promovohet zhvillimi i bujqësisë intensive;

QËLLIMI 5- Të krijohet një mjedis i favorshëm socio-kulturor, me prioritet arsimimin e brezave;

QËLLIMI 6- Të promovohet shfrytëzimi i burimeve natyrore korniza afatmesme buxhetore për Komunën e Vushtrrisë.

Korniza afatmesme buxhetore komunale e është pjesë përbërëse e Kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) të Kosovës dhe është e ndërlidhur në përputhje me procedurat buxhetore të dhëna nga MFPT-i përmes qarkores buxhetore. Korniza afatmesme buxhetore (KAB) komunale paraqet një segment të procesit të zhvillimit dhe hargjimit të buxhetit që bënë ndërlidhjen e resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, duke u bërë të qëndrueshme programet komunale gjatë periudhës së ardhshme 3 vjeçare. Me këtë kornizë Komunale do të paraqiten shpjegimet e politikave - prioritetet e tanishme dhe afatmesme si dhe projeksionet lidhur me

mënyrën me të cilën buxheti i Komunës do të përmbush projektet me prioritet që do të përcaktohen sipas buxhetit për vitet 2024-2026.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2024/01, e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, me të cilën caktohen kufijtë buxhetor të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2024-2026.

2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026 e Komunës së Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Planit Komunal për Integritet 2023 – 2025;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim miratohet Plani Komunal për Integritet 2023-2025 i Komunës së Vushtrrisë.

2. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë me miratimin e këtij dokumenti synon që të vlerëson integritetin e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe/ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin: Plani Komunal për Integritet 2023-2025 i Komunës së Vushtrrisë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryetari i Komunës së Vushtrrisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Vushtrrisë 2023 – 2025;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim miratohet Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riadhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vushtrrisë 2023-2025.

2. Me miratimin e këtij plani Komuna e Vushtrrisë ka për qëllim Avancimin e sistemit të ri integritetit për personat e riadhesuar, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është dokumenti me emërtimin: Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunën e Vushtrrisë 2023-2025.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim si dhe Komisioni Komunal për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Komunën e Vushtrrisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kuvendit në vazhdim i shqyrtoj në mënyrë të përbashkët pika 6 dhe 7 të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me rrugën “Wesly Clark”;

7. Shqyrtimi i Peticionit lidhur me ndryshimin e pikës 2 të vendimit nr. 82/23, të datës 30.03.2023;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se nga bisedat që ka pasur me qytetar të ndryshëm, ka ankesa që me këto vendime janë dëmtuar interesat e bizneseve dhe të ekonomive familjare dhe nga ajo që është parë gjatë këtyre ditëve ky vendim për kahet e rrugëve nuk ka ndikuar aspak në shkarkimin e rrugëve të qytetit. Po ashtu kemi parë që vendimi është zbatuar pjesshëm e jo siç është votuar në kuvend e cila përbën një shkelje tjetër. Prandaj si grup kuvendar i LVV-së mbështesin peticionet e qytetarëve për anulimin e pjesshëm apo në tërësi këtë vendim. Një vendim i cili ka për qëllim zvogëlimin e kaosit në qytet, nuk e ka arritur një synim të tillë sepse tollovit në qytet vetëm sa janë rritur. Me qenë se nuk kemi ndonjë përparim sa i përket këtyre vendime dhe nuk është arritur qëllim i vendim kërkoj që të njëjtat vendime të anulohen dhe të kthehet gjendje e mëparshme e ashtu siç ka qenë.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –njoftoi se këto peticione janë shqyrtuar edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në një mënyrë kemi ra dakord se vendimi ka qenë i qëlluar për arsye se ka ulur pritjet dhe bllokadat nëpër rrugë dhe tani komunikacioni zhvillohet shumë lirshëm se sa ka qenë para marrjes së këtij vendimi duke përfshi lokacionin para komunës po ashtu edhe tek rrethi tek ura e gurit ku ka qenë një nyje e zezë e funksionimit të komunikacionit, sepse atje pritjet kanë qenë 20 deri në 30 minuta për hyrë në qytet, ndërsa tani në pikun më të madh të ditës pritjet mund të jenë nga 3 deri në 5 minuta. Andaj nuk është mirë nga ana e parafolësit të dal e të flas në mënyrë populiste dhe se nuk mundesh kështu ta marrësh votën e qytetarit sepse realitet është kështu. Për ta diskutuar këtë temë është dashur të bëhen matjet para se të aprovohet ky vendim për tu ditur rezultatet. Mu për këtë drejtorja gjegjëse i ka bërë matjet dhe testimet e pritjeve të kolonave para aprovimit të këtij vendim dhe pas aprovimit të këtij vendimi. Andaj përfundimi është se pritjet janë vetëm 3-5 minuta tek rreth rrotullimi, ndërsa pjesa afër objektit të komunës është shkarkuar në tërësi dhe nuk ka fare pritje. E kupton shqetësimin e bizneseve dhe diskutimit duhet të jetë që atyre bizneseve të i'u minimizohet dëmi dhe inkurajoj qeverinë komunale që të bëjë parkingje publike afër skajeve të rrugëve, ashtu që bizneset më lehtë të funksionojnë. Vendimet madhore që vejnë rregull janë sfiduese, por ato duhet të mbrohen dhe të qohen deri në fund të njëjta kanë pasoja por ato janë në interes të përgjithshëm. Nëse dikush mendon në mënyrë populiste të mbroj kinse interesin qytetar atëherë ai publikisht i fton ata të heqin dorë nga kjo qasje.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se nuk qëndrojnë konstatimet e parafolësit të tij sepse kolonat dhe pritjet në rrugë prej se është marr ky vendim nuk janë zvogëluar por përkundrazi ato

janë rritur. Lidhur me këtë pyeti drejtorin e DSHP-së se a ka pasur prova a janë bërë teste dhe a ka pasur dëgjim publik para se të merret ky vendim në kuvend. Pastaj njëri nga peticionet që është adresuar para se të shqyrtohet nga kuvendi kjo qeveri ka vendosur që ta pranojë duke vepruar në zbatimin e pjesshëm të vendimit. Kjo me fjalë tjera i bie se pas që po merr vendim kuvendi, prapë po vepron sipas dëshirave të qeverisë duke mos respektuar vendimet dhe zbatuar vendimet e kuvendit. Në fund tha se nuk duhet të marrim vendime selektive por të vendosim për aprovimin e kërkesave dhe peticioneve të qytetarëve.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se parafolësi i tij ka diskutuar vetëm sa për të thënë diçka, në realitet asgjë nuk ka thënë sepse nuk ka dhënë asnjë shembull lidhur me qasjet dhe pritjet në rrugë, p.sh rruga afër komunës më herët pritja ka qenë 3 minuta ndërsa pas vendimit është 13 minuta kjo do të ishte fakt por ai nuk ofroj asgjë. Kjo qasje populiste kinse në mbrojtje të qytetarëve dhe të bizneseve është e pasinqertë dhe si e tillë nuk qon askund. Më tej shtoi se tani janë lajmëruar disa qytetar me peticione por duhet të vërtetohen edhe numrat e tyre personal dhe nënshkrimet e tyre se a janë të vërtetë, dhe a ka falsifikim të nënshkrimeve dhe nëse kjo vërtetohet atëherë aplikuesi duhet të shkojë në përgjegjësi.

Sylejman Mehollari, anëtar i kuvendit –tha se për këto peticione nuk duhet të referohemi me gjuhë politike sepse ai më së paku është duke bërë politikë, nuk e trajtojmë këtë situatë për politikë, sepse grupi i tij kuvendar prej fillimit ka qenë kundër aprovimit të këtij vendimi. Andaj grupi i tij po vazhdon ta mbroj me konsistencë votimin që ka ndodhur lidhur me këtë vendim. Më tej shtoi se qasja e tyre nuk ka të bëjë me përfitim të votave, por ka të bëjë me mbrojtjen e interesit të këtyre qytetarëve që kanë adresuar kërkesën e tyre se po iu dëmtohen bizneset e tyre nga ky vendim i marr më herët.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se për të hyrë në qytet nga pjesa e stacionit të vjetër të autobusëve, vetëm tani ka pritje në kolonë prej se është marrë ky vendim më herët asnjëherë nuk ka pasur pritje.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –tha se ky vendim i cili është marr më herët ka qenë vendim më meritor deri më tani. Kuvendi nuk i përfaqëson vetëm qytetarët që kanë nënshkruar peticionin, por gjithë qytetarët e Vushtrrisë dhe thënë realitetin shumë prej këtyre nënshkruesve nuk janë banorë të atyre rrugëve që po pretendojnë për dëmtim të biznesit. Tutje dha shembull konkret në diskutimin e tij përmbajtës duke vlerësuar se rasti se si është Vushtrria është tipik që duhet të funksionoj në bazë të rrugëve njëkahëshe, dhe po të pyetesh ai rrethi nga komuna në drejtim të lagjes Badivuku, e më pas kah monumenti i hammit e deri tek bankat, do të duhej të mbyllje krejtësisht për automjete, dhe nuk do të kishte fare dëmtim të biznesit sepse rast shkollor kemi Qytetin e Prizrenit ku në lagjet historike nuk ka fare lëvizje të automjeteve.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se numrat personal të nënshkruesve nuk korrespondojnë me peronat e nënshkruar sepse ka numra personal me ma pak se dhjetë numra dhe këtu del se këto janë të falsifikuara.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –tha se vendimi i cili është aprovuar ka qenë i duhur, por se çdo fillim i ka vështirësitë e vete por koha do ta vërtetojë se vendim është i drejt dhe do ta përmirësojë lëvizjen në komunikacion. Tutje shtoi se ky peticion është dashur fillimisht të verifikohet nga Komitetit për Politikë dhe Financa dhe më pas të dërgohet në kuvend për shqyrtim. Në këndin tjetër opozita ka për detyrë vetëm të gjej mangësi dhe të dal para qytetarëve të thotë se ata ishin në përkrahje të tyre por nuk gjeten mbështetje nga ana e pushtetit. Në fund se vota e tyre është që vendimi të mbetet në fuqi ashtu siç është vendosur.

Mek Selaci, anëtar i kuvendit –duke ju referuar diskutimeve për matjet në rrugë, shtoi se nëse flasim sinqerisht nëse futemi nga rrethi i flamurit në rr. Ismaj Qemajli, në drejtim të spitalit dhe

tek policia shohim se kemi kolona dhe vonesa të shumta të cilat nuk kanë qenë më herët. Më tej vlerësoi se të thuash se janë falsifikuar numrat në peticion vërtet nuk i bën nder askujt, dhe nëse i referohemi vendimit që është aprovuar mund të thuhet se në përqindje jashtëzakonisht të ulët është zbatuar dhe respektuar nga ana e qytetarëve. Pastaj shtoi se ka fjalë nga qytetarët se këto rrugë po dëshirojnë ti bëjnë me kahe për të bërë parkingje e për nderuara Kompani Vushtrria-Parking, për të ia dhënë tenderin më vonë ndonjë peroni të partisë që është në pushtet.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së-njoftoi se janë mbajtur dy takime me qytetar para se vendimi për kahet e rrugëve të aprovohet dhe atë kryesisht me banoret që i ka prekur ky vendim. Më tej tha se në rrugën Galip Badivuku, nuk është ndërmarr asgjë është gjendja ashtu siç ka qenë. Mandej peticioni i cili është adresuar në kuvend, nuk thotë se kemi kaos në qytet por ka ankesa se po zbrazen rrugët dhe po dëmtohen bizneset, dhe tani shtrohet pyetja se cilat interesa të qytetarëve po i mbron d.m.th a ka shkarkim a nuk ka shkarkim të këtyre rrugëve.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se lidhur me këtë vendim për kahet e rrugëve ka pasur disa ankesa nga qytetarët ndonjëherë edhe pa pasur bazë. Andaj shtoj dhe deklaroi se vendimet kapitale që merren nga komuna dhe kuvendi shpeshherë janë sfiduesi dhe hanin në problem për realizimin e tyre. Mirëpo duhet pritur deri sa të prodhojnë efektet e tyre për të vënë rregull në komunikacion. Ideja e kryetarit të komunës ka qenë që të bëhet shesh deri tek vendi i quajtur tek bankat, por reagimi qytetar ka qenë që mos të bllokohet ajo pjesë e qytetit. E vërteta është se për rrugët njëkahe nuk kemi pasur ankesa, më vonë janë bërë disa kalkulim dhe kemi pasur disa ndryshime në rrugë dhe defekti është tek ligji që për një rrugë prej 10 metrash nevojitet vendimi i kuvendit. Më tej njoftoi se ideja është që në bashkëpunim me HABITATIN të bëhet një ridizajnim i rrugëve në qytet për vënë rregull në komunikacion. Mandej frika se menaxhimin e këtyre rrugëve do ti japim ndonjë militanti partiak është e paqëndrueshme sepse menaxhimi i këtyre rrugëve do të bëhet nga Kompania “Përparimi”. Andaj kërkoj nga kuvendi që të delegohen përgjegjësit tek Drejtoria e Shërbimeve Publike për ti zhvilluar të gjitha analizat dhe matjet e nevojshme dhe për ta vendosur mënyrën më të mirë të funksionimit të komunikacionit dhe më tej të vihet në kuvend propozim për aprovim.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –tha se kemi hyrë në diskutime mjaft konfuze, për kërkesën e banorëve tek Rr.”Ismaj Qemajli” e cila funksionon akoma si një rrugë njëkahëshe dhe janë shfaqur probleme. Ai propozoi që nëse rruga mes objektit të Kadastrit dhe Restorantit Palma, është rrugë publike e njëjta të zgjerohet dhe mundësohet dhe të dile në rrugën kryesore që plotësohet kërkesa e atyre banorëve.

Adnan Lahu, anëtar i kuvendit –tha se nuk ka nevojë të zgjatet debati pasi që në fund po pushtetit po i përdor arrogancën e numrave. Mandej njëri nga peticionet është marr për bazë akoma pa ardhur në kuvend, kjo i bie se kuvend as që po merret për bazë dhe nuk po respektohen vendimet e kuvendit. Andaj propozimi i grupit kuvendar të LDK-së është të merren për bazë kërkesat e qytetarëve dhe vendimi të kthehet në pikën zero.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-njoftoi se lidhur me këtë çështje është mbajtur një takim publiku me banoret e kësaj rruge nënshkrues të këtij peticioni, mirëpo tani kjo çështje është në kompetencën e kuvendit për ta vendosur. Drejtoria e Shërbimeve Publike, ka bërë hapjen e një rruge për faktin se mos të shkaktoj tollovi në komunikacion. Ajo çka po diskutohet sot është dal jashtë rendit të ditës, sepse tema është se banoret e rrugës “Wesly Clark” kanë kërkuar të lëshohet në qarkullim në gjatësi vetëm 30 metra dhe për këtë edhe mund të kenë drejt. Andaj është mirë që kuvendi të japë të drejtë për pilotimin e rrugëve në qytetin e Vushtrrisë Drejtorisë së Shërbimeve Publike që të gjenet një zgjidhje sa më racionale që bënë rregullimin sa më të mirë të komunikacionit në qytet. Ky autorizim për të bërë pilotimin dhe testimin nga DSHP-ja, është mirë

ti jepet dy deri në tre muaj ditë për tu gjetur zgjidhja, dhe kjo çështje sërish të vjen në kuvend për aprovim ashtu siç parashihet me ligj. Ajo çka është e vërtet është fakti se në rr."Ismajl Qemajli" ka pasur kolonë, por është shkarkuar rruga afër komunës në udhëkryq, ku më herët kishte pengesa dhe tollovi në rrugë. Në këtë kontekst kishte me qenë mirë të kishim edhe kontraktimin e një kompani për hartimin e një projekti për rrugët dhe funksionimin e tyre. Një tjetër problem janë taksitë por edhe mungesa e parkingjeve në qytet, dhe sqaroi se tek spitali afër parkingu kishte me qenë mirë të vendoset ndalja dhe parkingu, ndër të tjera edhe shitësit dhe taksitë afër fabrikës të ngjyrave është duke e penguar komunikacion dhe në rreth për kyqje në qytet. Andaj përfundimisht shtoj nevojën për ti jap autorizimin DSHP-së që të bëj pilotimin e rrugëve në qytet dhe të vjen me një propozim racional dhe të duhur për aprovim në kuvend në ndonjërin nga seancat e kuvendit.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se krejt ideja është që t'i jepet autorizim DSHP-së për të bërë pilotimin e rrugëve në qytet dhe kështu të bëhet e mundur një qasje sa më funksionale e qytetit të Vushtrrisë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikët të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim autorizohet Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Vushtrrisë, që të bëjë matjet dhe pilotimin e rrugëve, dhe që të vendos për ndryshimin e kaheve të rrugëve në Rr."Wesly Clark" por edhe në rrugët tjera të Qytetit të Vushtrrisë.

2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që pas matjeve dhe një analize të hollësishme të gjendje së rrugëve të gjej një zgjidhje racionale dhe oportune, dhe më pas të sjell para kuvendit për aprovim propozim-vendimin për caktimin e kaheve të rrugëve në Qytetin e Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe drejtoritë tjera kompetent komunale.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë pas shqyrtimit të petitionit të banorëve që banojnë për gjatë rrugës "Wesly Clark" e parashtruar në emër të z.Shpend Badivukut, me anë të cilës kanë kërkuar që kjo rrugë të jetë dy kahore si dhe kërkesës së parashtruar në emër të z.Besnik Basholli që pika 2 e vendimit nr.82/23 të shfuqizohet ashtu që rrugua "Ismajl Qemajli" në drejtim të rr." Haxhi Zeka" të jetë me qarkullim dy kahor, kuvendi pas një analize dhe debati substancial, ka vendosur që këto peticione ti merr për bazë, duke autorizuar drejtorinë kompetent që bëjë matjet profesionale dhe të vjen deri tek një vendim sa më racional.

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, i merr për bazë shqetësimet e banorëve të cekur në peticione, për ankesa në të bërit biznes dhe zhvillimin e veprimtarisë së tyre biznesore, dhe zotohet se do të jetë përkrah bizneseve në të gjitha format e mundshme.

8. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë lidhur me caktimin Lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se le të rishqyrtohet ky vendim por të mbetet lokacioni i njëjtë për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq, ndërsa të mundësohet zhvillimi i negociatave për zhvillimin e këtij projekti me bashkëfinancim.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se ky vendim nuk i ka plotësuar konditat ligjore, andaj si i tillë duhet të shfuqizohet në tërësi, ashtu siç ka rekomanduar ministria gjegjëse. Kjo nënkupton se nuk ki lokacion të caktuar për ndërtimin e këtij objektit me vendim të kuvendit dhe për lidhjen e marrëveshjes për bashkëfinancimin e këtij projekti. Në të ardhme nëse lidhet ai memorandum me Kryqin e Kuq, prapë duhet të silllet para kuvendit caktimi i lokacionit për ndërtimin e këtij objekti.

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me numër të protokollit **nr. 50/23 i datës 23.02.2023 lidhur me caktimin e lokacionit** për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq-Dega në Vushtri, në pjesë të parcelës kadastrale P-70202016-02253-11, në sipërfaqe prej 500 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4300 m², Zona Kadastrale Vushtri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke marrë për bazë vlerësimin e ligjshmërisë të aktit në fjalë, të bërë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i propozon Kuvendit të komunës shfuqizimin e aktit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i kërkesës për financimin e botimit të librit “Rrezet e Lirisë – Dëshmorët e Kombit të Zonës së veprimit të Brigadës 142 të ZO të Shalës;

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-tha se duhet të mbështet kjo kërkesë për financimin e botimit të këtij libri pasi që ka karakter historik dhe i njëjti shpërfaq një periudhë të lavdishme të kujtesë tonë kolektive dhe të lartësimit të vlerave tona historike të luftës sonë të lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Andaj kërkoj nga kuvend që me vota unanime të mbështet kjo kërkesë financiare për botimin e këtij libri.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –paraqiti një ekspozitë të zgjeruar lidhur me vlerat e këtij libri e po ashtu prezantoi në pika të përgjithshme veprimtarinë e autorit të këtij libri ish-komandantit të Batalionit të dytë të Brigadës 142 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës z.Gani-Nezir-Lahu. Ai kërkoj që kjo kërkesë të aprovohet dhe autorit ti ndahen këto mjete, apo që Drejtoria e Financave dhe Drejtoria e Prokurimit të obligohen për ta marrë për sipër financimin e botimit të këtij libri.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së-tha se duhet shikohet mundësia që ky libër të financohet nëse ka kontratë me ndonjë shtëpi botuese, ndërsa tërhiqi vëmendjen që për ndarjen e subvencioneve të anulohet ndonjë aktivitet tjetër i paraparë që të subvencionohet. Ai propozoi që të autorizohet kryetari i komunës që të shqyrtoj këtë çështje dhe ti dal në ndihmë këtij autori për financimin e botimit të këtij libri.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se si grup kuvendar e përkrahin këtë kërkesë, për botimin e këtij libri i cila ka vlerën e vetë për zbardhjen e periudhe së lavdishme të UÇK-së në Zonën Operative të Shalës. Ai tërhoqi vërejtjen Drejtoreshës së Kulturës e cila nuk e ka bërë planifikimin e duhur për këtë aktivitet.

Pas shqyrtimi të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 19 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim autorizohet Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, e Komunës së Vushtrrisë, që të shqyrtojnë mundësitë financiare për ofrimin e mbështetjes financiare për botimin e librit “Rrezet e Lirës – Dëshmorët e Kombit të Zonës së veprimt të Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës”, të autorit Gani Lahu.

2. Kuvend e merr për bazë kërkesë e autorit të cekur në paragrafin 1 të këtij vendimi dhe autorizon Kryetarin e Komunës si dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, që autorit t’i ofroj mbështetje financiare për botimin e librit të cekur më lartë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

10. Shqyrtimi i Informatës për punën e Drejtorisë për Administratë, për periudhën janar – maj 2023;

11. Shqyrtimi i Raporti lidhur me gjendje momentale në Komunë Vushtrrisë pas vërshimeve dhe mundësia për përkrahje financiare për të dëmtuarit;

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-tha se e kemi analizuar anën ligjore dhe financiare pas gjendje nga vërshimet dhe jemi dakorduar që pjesa e subvencioneve prej 390.000.00€ të fuzionohet në zyrën e kryetarit për të mundur ti dalim në ndihmë banorëve që janë prekur nga vërshimet. Por për këtë qëllim do të dedikohen edhe fondet nga të hyrat e bartura nga vitet paraprake në vlerë prej 169.000.00 €. Sa i përket dëmeve në bujqësi komisioni është duke kryer punën në terren për vlerësimin e gjendje dhe më tej raporti do t’i dërgohet Ministrisë së Bujqësisë për kompensimin e këtyre dëmeve.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit –tha se grupi i tyre kuvendar do të përkrah çdo iniciativë për ofrimin e ndihmës për familjet e prekur nga vërshimet që kanë ndodhur ditëve të fundit. Ai theksoj se në krejt këtë fatkeqësi është mirë që si komunë kemi shpëtuar pa viktima dhe shpreh keqardhjen për të gjitha ata që pësuan dëme në pronat e tyre. Si grup kuvendar kanë propozuar që të bëhet një fond emergjent për këtë destinim dhe kërkoj që të hyrat e bartura të kenë epiqendër dhe fokus kompensimin e të prekurve nga vërshimet. Po ashtu kanë propozuar që familjet e prekura nga vërshimet të lirohen nga taksa e mbeturinave deri me 31 dhjetor 2024, pastaj fëmijët e këtyre familjeve që i kanë fëmijët në çerdhet publike të lirohen nga taksat për çerdhe, të lirohen nga pagesat në shëndetësi. Mandej është bërë një punë e mirë në pastrimin e lumenjve, por duhet punuar akoma në drejtimin e shtretërve të lumenjve dhe ndërtimin e urave por edhe në rregullimin

e kanalizimeve. Në fund falënderoj të gjithë aktore që kanë ofruar ndihmë për mënjanimin e kësaj situatë të jashtëzakonshme.

Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit-tha se komisioni për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet nuk e ka kryer si duhet punën e tij pasi familjet e prekura nuk i ka vizituar fare. Mandej shtoi se mbeturinat në shtratin e Lumit “Tërrsten” në disa rrugë që shtrihet andaj kërkoj që këto mbeturina të largohen nga atje.

Agron Përçuku, anëtar i kuvendit –propozoi që në komisionin për vlerësimin e dëmeve të jenë pjesë edhe nga anëtarët e kuvendit.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-shprehu keqardhjen e tij për krejt dëmet që janë shkaktuar nga vërshimet. Ai njoftoj se ka qenë një gjendje jashtëzakonisht e rënd, dhe është mundura që të evitohet këtë situatë por edhe i falënderon të gjithë operatorët privat për ndihmën që e kanë ofruar. Ai tha se nuk ka mundur që gjitha familjet e prekura ti vizitohet po shpreson se në ditën e vijim do ta bëjë këtë. Pajtohet se duhet të rritet fondi për emergjenca që tu dilet sa do pak në ndihmë familjeve të prekura nga vërshimet. Propozoi që ndahet një fond ai mund të jetë tek zyra e kryetari dhe ky fond do të dedikohet për kompensimin e dëmeve nga vërshimet. Ai është i mendimit që kompensimi i dëmit të jetë me përqindje konform dëmit të konstatuar e jo në formë lineare.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-pyeti se në çfarë mase është vërshuar shtëpia e shëndetit “Safet Idrizi” dhe a ka pasur dëmtim të pajisjeve mjekësore.

Në fund kuvendi vendosi të formoj një komision kuvendar për të i’u bashkangjitur komisionit aktuale për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet.

Në fund të debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 19 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim formohet komisioni për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet në Komunën e Vushtrisë në përbërjen si në vijim:

- 1.1. Arlind Gogolli, PDK;
- 1.2. Agron Përçuku, LDK;
- 1.3. Nasuf Aliu, LVV;
- 1.4. Bekim Zabergja, Nisma Socialdemokrate.

2. Komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendim i bashkëngjitet komisionit komunal, i formuar nga kryetari i komunës me qëllim të vlerësimit të dëmeve të shkaktuar nga vërshimet në Komunën e Vushtrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendim obligohet komisioni për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet në Komunën e Vushtrisë.

4. Ky vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrisë.

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ariani Company Sh.P.K. me pronarë Naser Imeri dhe pronës në pronësi komunale;

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-tha se kjo pikë e rendit të ditës ka ardhur me shumë vonës dhe e njëjta ka një materiale voluminoz që nuk kemi mundur të shqyrtojmë si dhe po ky material nuk i ka kaluar filtrat e duhur siç është KPF-ja, propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme. Po ashtu në këtë material ka gjëra të paqarta p.sh për shkëmbim të pronës duhet ta kemi të qartë se për çka do të përdoren këtë dy parcela, po ashtu është i nevojshëm një dokument nga AKP me të cilin vërtetohet se prona nuk është e ndërmarrjes shoqërore po ashtu për këtë është e nevojshme që të kemi një dokument nga gjykata komunale në Vushtri me të cilën vërtetohet se nuk ka rast të pazgjedhur lidhur me pronën në fjalë. Në fund deklaroi se nuk janë kundër bizneseve në Vushtri por duhet të respektohen dispozitat ligjore.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit –tha se kësaj lënde është dashur ti bashkëngjitet lista poseduese dhe kopja e planit, mirëpo kjo lëndë i është nënshtruar vlerësimit të pronës nga ministria gjegjëse, e cila e ka aprovuar raportin dhe lejohet në këtë rast këmbimi.

Në vazhdim mbledhja e kuvendit e datës 29 qershor u ndërpre, pasi që numri i anëtarëve të kuvendit kishte rënë nënë numrin e paraparë për vazhdim të punimeve të mbledhjes plenare (mungesë e kuorumit) ora:15:38. Kryesuesja e kuvendit e ndërpreu mbledhjen bazuar në rregulloren e punës të kuvendit, ndërsa deklaroi se për vazhdimin e mbledhjes do të njoftohen në kohë me shkrim.

Më datën 30 qershor 2023 ditë e premte ora 16:10 kryesuesja e kuvendit hapi punimet e mbledhjes së ndërprerë të datës 29 qershor 2023, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 19 anëtarë të kuvendit kuorum i mjaftueshëm për marrjen e vendimeve të plotfuqishme me pika e rendit të ditës në renditje numërore pikat 12, 13 dhe 14 të mbetura nga mbledhja e ndërprerë.

Prezent ishin këta anëtar të kuvendit: Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Faton Hyseni, Galip Audiu, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Nurie Halili, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Spasoje Stefanoviq, dhe Zojë Hajrizi.

Munguan: Adnan Lahu, Agim Bregaj, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fatmire Cecelia, Fakete Dushi, Gresa Muli, Gentiana Rama, Leonora Gërguri, Mek Selaci, Nasuf Aliu, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Sylejman Meholli, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, dhe Ymer Haradinaj.

Kuvendi pas shqyrtimit të propozim-vendimit për aprovimin e propozimit të kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Ariani Company Sh.P.K. me pronarë Naser Imeri dhe pronës në pronësi komunale, Kuvendit i Komunës së Vushtrisë pas votimit me 19 vota për (sa edhe ishin prezent) vendosi me sa vijon:

1. Miratohet propozimi i kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajjtshme komunale me pronën e paluajjtshme në pronësi të Ariani Company Sh.P.K. me pronarë Naser Imeri.

2. Prona e paluajjtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr.P-70202016-01103-0 me shfrytëzim aktual Rrugë e pakategorizuar me sipërfaqen e përgjithshme $S=2065m^2$ nga e cila është propozuar të merret sipërfaqe prej $276m^2$ dhe pjesa tjetër po nga kjo parcelë të merret $S=36m^2$ e cila është në pronësi të komunës së Vushtrrisë dhe pjesa tjetër e propozuar për këmbim e cila është pronë e Ariani Company SH.P.K. është sipërfaqja prej $S=166m^2$ e marr nga parcela me nr.P-70202016-06520-0 e cila ka një sipërfaqe të përgjithshme prej $S=541m^2$, sipërfaqet prej $S=65m^2$ dhe $S=33m^2$ përbri rrugës e që janë pjesë e parcelës kadastrale me nr.P-70202016-06521-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S=1553m^2$ dhe sipërfaqja $S=48m^2$ edhe kjo përbri rrugës e cila është pjesë e parcelës me nr.P-70202016-06538-0, e cila ka sipërfaqe të përgjithshme prej $1154m^2$.

3. Këmbimi i pronës së paluajjtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtat për zgjerimin e kësaj rruge publike bazuar në profilin e rrugës sipas Planit Zhvillimor Komunal 2016-2024.

4. Këto prona ju janë nënshtruar vlerësimit të pronave nga Zyra për Vlerësimin e pronës së paluajjtshme pranë Departamentit të Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

5. Pronat e paluajjtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara si në pikën 2 të këtij vendimi, duhet të evidentohen në elaboratin kadastral (librat kadastral) të Komunës.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

7. Ky Vendim hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim –vendimit për financim të përbashkët të projektit ‘‘ndërtimi i objektit për nevoja të kryqit të kuq të Kosovës dega në Vushtri’’;

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke njoftuar se është arritur marrëveshja me kryqin e kuq për financimin e përbashkët të projektit ndërtimi i objektit për Kryqin e Kuq të Kosovës Dega në Vushtri, ndër të tjera Komuna e Vushtrrisë do të financoj 40% të vlerës së projektit nga buxheti i vitit 2023/2024 – fondi për bashkëfinancim në Drejtorinë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural përkatësisht vlera me vlerën financiare prej 89,999.09 €, ndërsa Kryqi i Kuq i Kosovës do të financoj 60% të vlerës së projektit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 19 vota “për” (sa edhe ishin të pranishëm në mbledhje) vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim miratohet financimi i përbashkët i projektit për ndërtimin e objektit për nevoja të Kryqit të Kuq të Kosovës dega në Vushtrri në vlerë të paralogariturë 89,999.09 € (tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro e nëntë cent).

2. Bashkëfinancimi i projektit nga pika paraprahe e këtij vendimi do të bëhet si vijon:

2.2. Komuna e Vushtrrisë do të financoj 40% të vlerës së projektit nga buxheti i vitit 2023/2024 – fondi për bashkëfinancim në Drejtorinë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural;

2.3. Kryqi i Kuq i Kosovës do të financoj 60% të vlerës së projektit.

3. Ndërtimi i objektit do të bëhet në parcelën Kadastrale nr. P-70202016-02253-23 në sipërfaqe prej 500 m² Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

4. Realizimi i këtij projekti do të bëhet brenda vitit 2023/2024.

5. Objekti i cili do të ndërtohet sipas projektit regjistrohet në RDPP në pronësi të Komunës së Vushtrrisë dhe Kryqit të Kuq të Kosovës sipas përqindjes së mjeteve financiare me të cilat kontribuojnë në realizimin e këtij projekti.

6. Kryqi i Kuq dega në Vushtrri do t'a shfrytëzoj objektin për nevoja të veta në afat të pacaktuar dhe pa kompensim.

7. Autorizohet Kryetari Komunës që të lidhë marrëveshje mirëkuptimi me përfaqësuesin e Kryqit të Kuq në të cilën do të përcaktohen detajet rreth ndërtimit dhe shfrytëzimit të hapësirave të objektit siç është cekur në këtë vendim.

8. Procedurat e tenderimit për ndërtimin e objektit të përcaktuar në këtë vendim do të zbatohen konform legjislacionit në fuqi.

9. Mjetet financiare të mbetura pas përfundimit të projektit do të iu kthehen Komunës së Vushtrrisë përkatësisht Kryqit të Kuq bazuar në përqindjen e mjeteve me të cilat kanë participuar.

10. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryqi i Kuq i Kosovës.

11. Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

14. Të ndryshme;

Ali Januzi, anëtar i kuvendit-ngriti shqetësimin e tij lidhur me rrugën që degëzohet nga fshati Sllatinë në drejtim të fshatit Pasomë, e cila pas vërshimeve të fundi është dëmtuar tej mase dhe po thuhet se është bërë e pa kalueshme. Kërkoj nga organet komunale që të ndërmarrin veprime të menjëhershme në rregullimin –riparimin e kësaj rruge.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës-paraqiti sqarime lidhur me kërkesën e parafolësit ku deklaroi se për rrugën në fshatin Pasomë do të thirren kompanitë që janë duke punuar në gurthyes lartë në fshatë, ku dëmi më i madh është shkaktuar nga këta gurthyes, por ideja e qeverisë komunale është që futemi në bashkëfinancim me këto kompani për rindërtimin nga fillim të kësaj rruge. Në të kundërtën këto kompani do të mund të penalizohen për mos veprim. Në një tjetër drejtim kjo rrugë mund të rindërtohet me buxhetin për vitin 2024.

Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit –ngriti problemin e riparimit të sistemit të kanalizimit në fshatin Samadrexhë, kërkoj që urgjentisht të evitohet ky problem.

Benjamin Shala, drejtor i DSHP-së tha se problemi me kanalizim do të rregullohet shumë shpejt.

Ergyn Sunguri, drejtor i DEBPZHR-së-kërkoj nga anëtarët e komisionit kuvendar për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet që ti bashkëngjiten komisionit komunal për ta ndihmuar procesin e vlerësimit të dëmeve.

Mbledhja përfundoi në ora: 16:25.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Melihate Basholli-Latifi




Kryesuese e Kuvendit